

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trafiku i drogës - VIDEO - Kakavijë/ Kapet 'ngarkesa' prej 91 kg kanabis, në pranga çifti i bashkëshortëve
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/919462/video-kakavije-kapet-ngarkesa-prej-91-kg-kanabis-ne-pranga-cifti-nga-ballshi/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 09:22:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 09:01:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8a8a8f12acebc03434703153f2b77e60d81ddd964a856bb7fec9ae019288084
TEKSTI	39df5710ddedf76420c2abcf7c67f99f1217720455af910bc55848b7c8d695ac
PAMJA	27b0fdfecbd318224e5fb8c0f09c352184a881106f3b0098fce37d4efe1f5521

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	927b43c379db3dcb230465c85f3deb5b516cdc90c96edbcfc44ae92525ddb95f
E MËPARSHMJA	e95a8533b699f452b476b36eee922eee4296b9949df27341176bc6b477cde417
RRËNJA MERKLE	48d5adc2dc979f83a887c219539e18c9885fc52000dc610804adb08caf975432
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/927b43c379db3dcb230465c85f3deb5b516cdc90c96edbcfc44ae92525ddb95f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**FATMIR MEDIU**

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve



VIDEO - Kakavijë/ Kapet 'ngarkesa' prej 91 kg kanabis, në pranga çifti i bashkëshortëve

11:01, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Kapet një sasi e madhe droge në Pikën Kufitare të Kakavijës. Ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit, teksa një furgon që dyshohet se po tentonte të trafikonte drogë nga Shqipëria drejt Greqisë është ndaluar nga shërbimet e Policisë Kufitare.

Furgoni është ndaluar në vijën e dytë të kontrollit kufitar, ku gjatë kontrollit është konstatuar dhe sekuestruar një sasi e konsiderueshme lëndë narkotike të dyshuar kanabis sativa, me peshë 91 kilogramë.

Në vijim të veprimeve, dy persona janë shoqëruar në ambientet e Policisë së Gjykostrës, ku po kryhen veprimet procedurale.

Ndërkohë, grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të rastit, përfshirë identifikimin e personave të tjerë që mund të jenë të përfshirë në këtë tentativë trafikimi.

Sasia e lëndës narkotike po peshohet dhe po kryhen veprimet e mëtejshme procedurale për dokumentimin e plotë të rastit.

Ndërkohë gazetari i Syri meson se të ndalura janë një çift nga Ballshi është ndaluar nga shërbimet e Policisë Kufitare në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës.

Sipas të dhënave paraprake, çifti udhëtonte me një automjet tip Mercedes-Benz, gjysme furgon, i cili është përzgjedhur për kontroll të imtësishëm.

Gjate kontrollit me skaner, në pjesën e ngarkesës së mjetit janë evidentuar 88 pako, me peshë totale rreth 91 kilogram.

Pas zbulimit, automjeti dhe ngarkesa janë bllokuar, ndërsa dy personat janë ndaluar nga Policia Kufitare. Në vijim pritet të përcaktohet përmbajtja e pakove dhe të dokumentohen veprimet procedurale.

Njoftimi i policisë:

PKK Kakavijë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Risku 1".

Falë kontrolleve të shtuara nga Policia Kufitare bazuar në analizën e riskut,

më të lexuarat



Aksidenti tragjik në Fushë-Krujë, Forcat e Armatosura në zi për 19-vjeçar: Ishte student i Akademisë



FOTO/ Shqiptarët arratisen me një BMW X6 të vjedhur, aksidentojnë tre makina dhe plagosin një polic



Zjarret/ Në qarkun Lezhë u dogjën 2500 hektarë pyje dhe 12 banesa



'Porositësit e ushqimit'/ Lushnje, arrestohen shitësit e kokainës, e shpërndanin me motora



EMRAT/ Plagosën të riun pas sherrit për riparimin e makinës, shpallen në kërkim babë e bir



Atentati në Athinë/ Lokali në pronësi të Denis Lulit, urdhri dyshohet të jetë dhënë nga Klod Cara



parandalonit dhe goditet një rast i tentativës për trafikimin e lëndëve narkotike drejt Greqisë.

Gjatë kontrolleve intensive, me përdorimin e mjeteve logjistike bashkëkohore, shërbimet e Policisë gjetën të fshehura në brendësi të një furgoni rreth 88 pako me lëndë narkotike të dyshuar cannabis, me peshë totale rreth 91 kilogramë.

Vihet në pranga drejtuesi i furgonit dhe pasagjerja, bashkëshortë me njëri-tjetrin.

Shërbimet e Policisë Kufitare, si rezultat i kontrolleve të imtësishme për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e tentativave për trafikimin e lëndëve narkotike, si dhe i intensifikimit të kontrolleve bazuar në analizën e riskut në bashkëpunim me specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Gjirokastrë, kaluan për kontroll të detajuar në skaner dhe më pas në vijën e dytë, në dalje të RSh-së, furgonin që drejtohej nga shtetasi K. A..

Nga kontrolli i imtësishëm, shërbimet e Policisë gjetën të fshehura, në vende të krijuara posaçërisht në dyshemenë e furgonit, poshtë shtresës së saj, rreth 88 pako, brenda të cilave kishte lëndë narkotike të dyshuar cannabis, me peshë totale rreth 91 kilogramë.

Në vijim të veprimeve të para hetimore, specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Gjirokastrë arrestuan në flagrancë shtetasit K. A., 28 vjeç, dhe B. A., 25 vjeçe, të dy banues në Tiranë, bashkëshortë me njëri-tjetrin.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan rreth 91 kilogramë lëndë narkotike e dyshuar cannabis dhe furgoni.

Strukturat e DVP Gjirokastrë, në bashkëpunim me DVP-të e tjera, nën drejtimin e Prokurorisë së Gjirokastrës, po vijojnë veprimet hetimore për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Trafikimi i lëndëve narkotike".



© SYRI.net

Lexo edhe:



Fier/ Automati në banesë, arrestohet 66-vjeçari - gjendet edhe një 'Benz' i trafikuar nga Britania



Gjykata e Posaqme cakton arrest me burg për Beldar Cadin



Furnizonin më drogë shkollat e Tiranës - Mes 31 të arrestuarve edhe një ish-efektiv policie

Vrasja në Tiranë/ Zbardhet dëshmia e autorit: U zëmë me fjalë, e godita disa herë me thikë në bark

Rodos/ Shqiptari i merr 15 mijë euro polakes dhe e kërcënon me fotot nudo

Detaje tronditëse/ Ergys Agasi mori të dhënat e telefonave të 'zbërthyer' nga policia

TË NGJASHME



Goditen disa grupe që shishnin drogë pranë shkollave në Tiranë, arrestohen



Shpërthen bombola e gazit në një banesë në Maliq, plagoset 74-vjeçari



Maliq/ I rrëshqet makina dhe e zë poshtë, humb jetën 43-vjeçari



Vrasja e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikon akuzën Elvis

31 persona

Shkambit



Gazetari Hoxha: Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi u njohën në Kryeministri



VIDEO/ Merr flakë autobusi me pasagjerë në hyrje të tunelit të Elbasanit, bllokohet qarkullimi



Shpërthimi në Greqi/ Humbin jetën 3 shqiptarë! Mes viktimave një çift i sapomartuar në muajin e mjalutit

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.